

Detaje për vdekjen e prishtinasit që u plagos nga policia gjatë një bastisjeje në maj

LAJME



01/06/2022 08:54



Policia e Kosovës ka njoftuar për vdekjen e një personi përgjatë ditës së djeshme, i cili është plagosur me armë zjarri nga zyrtarët policorë.

PK, në raportin e përditshëm, ka bërë të ditur se ai po trajtohej në QKUK për plagët e marra, shkruan lajmi.net.

“Rr. Abaz Shehu, Prishtinë 08.05.2022 – 09:10. Lidhur me rastin, me 31.05.2022 personi që ishte duke u trajtuar në QKUK, ka vdekur. Me vendim të prokurorit, trupi i pajetë është dërguar në IML për obduksion”, thuhet në njoftim.

Përgjatë bastisjes të shtëpisë së të ndjerit gjatë muajit të kaluar, policia kishte konfiskuar një arsenal armësh.

“Prishtinë 08.05.2022-09:10. Pas disa të shtënave me armë zjarri të raportuar më parë, policia me autorizimin e Prokurorit të Shtetit, ka bërë kontrollimin e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të dyshuarit mashkull kosovar. I dyshuari ka kanosur me armë zjarri zyrtarët policorë duke ua kanosur jetën drejtpërdrejtë, me ç rast në vetmbrojtje dhe për të vënë situatën nën kontrollë njëri nga zyrtarët ka përdorur armën ndaj të dyshuarit. Si dëshmi materiale janë sekuestruar : pesë pistoleta, një AK-47, 694 copë fishekë të kalibrave të ndryshëm, 58 gëzhjoja dhe 4 predha. I dyshuari është duke u trajtuar në QKUK dhe nën sigurimin e policisë”, u bë e ditur në njoftimin e muajit të kaluar. /Lajmi.net/

Artikuj të ngjashëm



June 1, 2022

Policia sekuestron rreth 18 kg drogë, arrestohen dy persona – i...



June 1, 2022

Stoltenberg do të thërrasë takim për kundërshtimin e Turqisë ndaj zgjerimit...



June 1, 2022

Meta vlerëson me “Dekoratën e Flamurit Kombëtar” ish-presidentin Nishani...



June 1, 2022

MZHR reagon ndaj akuzave të PDK-së për keqpërdorim të buxhetit shtetëror...



June 1, 2022

Nushi i PSD-së i reagon Sallahut të VV-së: Po shpërndani budallak...



June 1, 2022

Kurti-Bjerde diskutojnë mbi stabilitetin institucional